



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Elektra
Hebib DERMJANI
Drejtor
Elez Han

Ankesa Nr. 2015/170 KPM vs Elektra
Ref:1510/1285/KPM/am

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2015/170 – Komisioni i Pavarur i Media (KPM) kundër Elektra
("Pala Përgjegjëse")

Faktet

1. Pala Përgjegjëse me datë 5 gusht 2009, është pajisur me licencë të KPM-së. Me marrjen e Licencës Pala Përgjegjëse është obliguar që të respektojë Ligjin e KPM-së, Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës si dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM.
2. KPM, me datën 23 prill 2015, ka pranuar një ankesë të parashtruar kundër Palës Përgjegjëse lidhur me bartjen e kanaleve të platformës DigitAlb. Ankesë është parashtruar nga bartësi i të drejtës së kanaleve të platformës DigitAlb për territorin e Republikës së Kosovës, operatori kabllor IPKO.
3. KPM, me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës Përgjegjëse me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, me datën 9 qershor 2015, ka bërë monitorimin e Palës Përgjegjëse në selinë e tij dhe bazuar në raportin e monitorimit të datës 30 qershor 2015, ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka transmetuar 26 kanale për të cilat nuk ka deponuar dëshmi në KPM se ka të drejtën e ritransmetimit të tyre. Në kuadër të platformës së Palës Përgjegjëse nuk janë gjetur kanale të platformës DigitAlb ashtu siç pretendon pala ankuese IPKO.
4. KPM duke u bazuar në monitorimin e bërë me datën 16 qershor 2015, përmes një kërkesë ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse, që në afat prej pesë (5) ditësh t'i sjellë marrëveshjet valide me të cilat dëshmon se ka të drejtën e bartjes së 26 kanaleve. Pas kërkesë së marr Pala Përgjegjëse ka arritur t'i siguroj kontratat për 21 kanale nga 26 sa ishin gjetur, kurse për 5 kanale kishte dështuar t'i depononte kontratat në KPM.

5. KPM, bazuar në shkeljen e Kushteve dhe Termet e Përgjithshme të Licencës nga ana e Palës Përgjegjëse, me datën 7 korrik 2015, i ka dërguar Njoftim për Shkelje me të cilin ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse të veprojë në pajtueshmëri me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, në të kundërtën KPM do të ndërmarrë masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse.
6. KPM, me datën 15 korrik 2015, ka pranuar një përgjigje nga Pala Përgjegjëse, përmes të cilës pretendon se ka bërë ndërprerjen e bartjes së të kanaleve dhe se ka nisur negocimin për marrjen e pëlqimit për bartjen e tyre.
7. KPM, bazuar në shkeljen e Kushteve dhe Termet e Përgjithshme të Licencës nga ana e Palës Përgjegjëse, me datën 5 gusht 2015, i ka dërguar Kërkesë që në afat prej pesë (5) ditësh t'i sjellë marrëveshjet valide me të cilat dëshmon se ka të drejtën e bartjes së 4 kanaleve
8. KPM në bazë të raportin të monitorimi të datës 13 gusht 2015 ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka deponuar marrëveshje për kanalet tjera, mirëpo ka dështuar t'i deponojë marrëveshjet për dy kanale pa të drejtë autoriale të cilat janë *TV Arta dhe Eurostar*.

Analiza Ligjore

9. Komisioni i Pavarur i Media bazuar në faktet e lartpërmendura konkludon se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 2, paragrafi 2.1.3, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.

Neni 2, paragrafi 2.1.3 i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës përcakton se:

"I licencuari nuk do të ri-transmetojë asnjë program pa marrëveshje valide mbi të drejtën autoriale. Bartja e kanaleve të programeve pa të drejtën autoriale përbën shkelje të rëndë të Kushteve dhe Termeve të Licencës dhe shkeljet e tilla rezultojnë me revokim të Licencës".

10. Bazuar në raportet e monitorimit është gjetur se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 2, paragrafi 2.1.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, pasi që në mënyrë të vazhdueshme ka bërë bartjen e kanaleve pa të drejtë autoriale.
11. Komisioni i KPM-së, duke u bazuar në raportet e monitorimit gjen se Pala Përgjegjëse ka dështuar që të marrë hapa të nevojshme për të ardhur në pajtueshmëri me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, duke transmetuar kanale pa të drejtë autoriale.
12. Bazuar në raportet e monitorimit është gjetur se Pala Përgjegjëse edhe përkundër Njoftimit për Shkelje, dhe kërkesave të dërguar nga KPM përmes të cilave i është bërë me dije se është në shkelje të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, Pala Përgjegjëse ka vazhduar t'i ritransmetojë dy kanale pa të drejtë autoriale.
13. Komisioni si rrethanë lehtësues në këtë rast merr për bazë faktin se Pala Përgjegjëse, bazuar në monitorimin e fundit të datës 13 gusht 2015, për 24 kanale ka siguruar marrëveshje për të drejtën autorial, ndërsa mbetet në shkelje për dy kanale.

14. Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura, Komisioni i KPM-së vlerëson se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 2, paragrafi 2.1.3, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, ka bërë bartjen e kanaleve pa të drejta autoriale.

Vendimi

15. Komisioni, bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se, Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 2, paragrafi 2.1.3, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, pasi që ka bartur kanale pa të drejtë autoriale.
16. Komisioni, vendosi që në pajtim me nenin 30, paragrafi 1.3 të Ligjit të KPM-së, Pala Përgjegjëse të sanksionohet me gjobë në shumën prej 1,000 (njëmijë) euro, për shkeljen e vazhdueshme të nenit 2, paragrafi 2.1.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.

E drejta për Ankesë

17. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
18. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjrisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

Lëshimi i Vendimit

Komisioni e lëshon këtë vendim


Adnan MEROVCI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave

27.10.2015

datë

1285

Lloji i dërgesës _____
Vista postiljke _____

Vlera e cekur - Shuma e dërguar _____
Oznaçona vlerësi - postani iznos _____

nën numër _____
pod br. _____

për _____
za _____
RECIPITRA / HERIBI DERMÖANI
RR/ ADEM JASHARIJ PN / ELIZ HAN

(Vendi)
(Mesto)

Posthtë i nënshkruar deklaror që dërgesa e cekur (shuma e dërguar) është dorëzuar në tregull (paguar me datë) _____
Dole potpisani izjaviluje da je pomenuta pošiljka (postani iznos) predata uredno (placena dana) _____
28. 10 / 11

Nënshkrimi i marrësit
Potpis primaoca _____
Vula e postës së vendit
Peçat pošte _____

Nënshkrimi i nënpunësit
të postës së vendit
Potpis radnika pošte _____



Handwritten signature or initials.